

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kriza politike në Kosovë, PDK çon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit dhe votimin e Qeverisë "Kurti 4"
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/kriza-politike-ne-kosove-pdk-con-ne-kushtetuese-konstituimin-e-kuvendit-d-i585887
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:12:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 19:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0570c24ebd4dd4a455d69078bfa66e760f5de21bf8f5861669e1dfb5a80083a0
TEKSTI	b771b2ae3dd58260ef7b4cfd6c059ed022681c0358f2c2df5e0eb3aa3acba4f3
PAMJA	f5f4b8a2b5d20ef5b72e966dd1aea94866eb59df63e7bfdae6dd1d95f5099dee

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	982af5fa85f75265aae45cbd29a9ccecbbcfaf2fee89cd6f99ab72b647d3d3c1b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/982af5fa85f75265aae45cbd29a9ccecbbcfaf2fee89cd6f99ab72b647d3d3c1b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Magyar: Do te hiqet kuhzim i epokes se Urbanit qe ndaionte adoptimin e femnjeve nga homoseksualetNdryshon vettingu per policet, levizja nga detyra nuk do t'i shpetoj fundit

Kriza politike në Kosovë, PDK çon në Kushtetuese konstituimin e Kuvendit dhe votimin e Qeverisë “Kurti 4”



13 Shtator 2026, 21:40Rajoni TEMA



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ka ftuar Partinë Demokratike të Kosovës për bashkëpunim në Kuvend, duke kërkuar që kjo parti të propozojë sa më shpejt kandidatin për nënkryetar të Kuvendit. Ndërkohë PDK-ja ka njoftuar se të hënën në orën 09:00 do të dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese për interpretim rastin e konstituimit të Kuvendit të Kosovës dhe votimit të qeverisë së re të dielën.

Deputeti i PDK-së Arian Tahiri, në një konferencë për media tha se konstituimi i Kuvendit ka hyrë në një fazë që kërkon qartësi kushtetuese.

“Partia Demokratike e Kosovës vlerëson se situata e krijuar rreth konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës ka hyrë në një fazë që kërkon qartësi kushtetuese. Pas shkeljes së afateve, bllokimit të përsëritur dhe vendosjes së kushteve të reja politike nga Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës e ka bërë qëndrimin e vet publik edhe në seancën paraprahe kur nuk është votuar nënkryetari jonë për nënkryetar të Kuvendit”, tha Tahiri.

Tahiri tha se Kurti ka shpërfillur rendin kushtetues dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

“Zoti Kurti ka luajtur gjatë gjithë kësaj kohe me institucionet, ka shpërfillur rendin kushtetues dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. I ka shkelur afatet kushtetuese për interesa të ngushta politike dhe ka tentuar të luajë edhe me figurat politike të subjekteve opozitare. Ai gjatë gjithë kësaj kohe ka bërë manovra politike për ta jetësuar skenarin e tij politik”, shtoi ai.

Deputeti u shpreh se çdo gjë që del nga ky Kuvend, do ta dërgojnë në Kushtetuese.

“Procedimet e sotme dhe konstatimet e tyre se Kuvendi është konstituar janë përtej afateve kushtetuese dhe gjithçka që del nga ky Kuvend, ne do ta dërgojmë për shqyrtim të ligjshmërisë në Gjykatën Kushtetuese. Kosova duhet të funksionojë sipas rendit kushtetues dhe jo sipas një rendi që tenton ta krijojë Kurti për interesat e tij politike. Ekspertët e Partisë Demokratike të Kosovës tashmë janë duke punuar në përgatitjen e rastit i cili do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për procesin në tërësi”, shtoi Tahiri.

Legjislatura e njëmbëdhjetë e Kuvendit të Kosovës është konstituar të dielën me votimin e nënkryetarëve të Kuvendit.

Kuvendi i Kosovës në seancën e sotme zgjodhi Kujtim Shalën e LDK-së për nënkryetar, nga komuniteti jo serb Emilja Rexhepin dhe Tanja Vujovićin nga Lista Serbe

Ardian Gola u zgjodh nënkryetar të premtën. Gjithashtu sot është votuar edhe Qeveria "Kurti 4" në një seancë të jashtëzakonshme me 62 vota pro.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Vendimi për ish-krerët e UÇK-së, Gucati apel BE-së dhe ambasadorëve: Mos bëni politikë me 16 shtatorin](#)

Gjyqi i ish krerëve të UÇK/ Ministri i Drejtësisë së RMV: Respektoni gjykatën dhe vendimin! BDI: Palo-ministër, barazon viktimën me agresorin

19:00 Rajoni / 12 komente

Kosova me Qeveri të re! Me 62 vota pro, Kuvendi miraton kabinetin e Albin Kurtit

16:16 Rajoni / 19 komente

[“Patriotizmi sot paska pushim” / Përparim Rama ironizon Vetëvendosjen pas votës për deputeten e Listës Serbe](#)

15:50 Rajoni / 7 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.